

Këngë të partishme që të emocionojnë

(Shënime për festivalin e 8-të të këngës në Durrës)

Avni Mula

Artist i Popullit

Festivali i 8-të i këngës në Durrës, që u zhvillua pak ditë më parë, pas fjalimit të shokut Enver Hoxha të 20 dhjetorit 1974 dhe në kuadrin e fushatës së zgjedhjeve në Parti, ishte një ndër aksionet më të rëndësishme artistike në atë rreth. Ky festival tregoi se forcat artistike amatore të qytetit të Durrësit janë tani në rruqën e një hopi të madh cilësor përpara. Kompozitorët, poetët si edhe ekzekutuesit e këngëve i dhuruan publikut artdashës këngë të realizuara, me partishmëri, tematikë të shëndoshë e të mbështetur në krijimtarinë popullore. Shpesh, gjatë koncerteve në netët e festivalit, publiku duartrokiti i emocionuar. Dhe kjo nuk ndodhi rastësisht. Spektatori reagon ndaj këngës së bukur kur ajo është e krijuar me frymëzim, mbart mendime dhe ndjenja të fuqishme kombëtare, ka një gjuhë të qartë.

Në festivalin e 8-të të këngës në Durrës jehoi kënga për Partinë tonë, për udhëheqësin e dashur shokun Enver Hoxha, për heronjtë tanë të Luftës dhe të punës. Të tilla ishin këngët «Më e madhja e

të gjithë dashurive» e P. Gacit, me tekst të B. Agasit, «Nënë e bir» e A. Xhungës, me tekst të M. Gjellucit, «Komisari i Partisë» e M. Beqirit, me tekst të J. Beqirajt etj. Krahas këtyre, pati në festival edhe këngë të bukura me motive nga jeta dhe puna e ditëve tona në kantiere ndërtimi e gjetkë, siç ishin këngët «Letër nga Fierza» e F. Ibrahimit, me tekst të M. Zeqos, «Djemtë e lagjes sime» e Z. Qukut, me tekst të P. Qafzezit, «Ne jemi ushtarë» e F. Dedës, me tekst të Xh. Jorganxhiut. Pati, gjithashtu, edhe këngë me një tingëllim më të afërt me këngën popullore, si ajo e M. Bashës «Valles popullore», me tekst të Th. Bellos, «Kur vjen artisti tek punëtori» e T. Kutinës, me tekst të M. Gjergjit etj. Siç shihet, tematika e larmishme nuk mungoi, aq më tepër të entuziazmon kjo dukuri pozitive, kur kemi të bëjmë me një festival kënge, i cili është kryesisht rezultat i punës krijuese dhe ekzekutive e lëvizjes amatore dhe profesioniste të një rrethi. Por ndoshta do të qe edhe më mirë që kësaj larmie tematike forcat kriju-



ese, sidomos kompozitorët, t'i ishin përgjigjur edhe me një larmi më të madhe të llojeve të këngës. E vërteta është se në këtë festival pati edhe në këtë drejtim disa anë të mira. Kishte këngë himnizuuese si «Më e madhja e të gjithë dashurive», «Mal në Shqipëri» etj. Kishte këngë lirike si «Këngëtar i lumturisë» e J. Llapës me tekst të P. Ristos, «Sytë e mi të flasin qartë» e T. Harapit, me tekst të Xh. Malltezit; bile pati këngë me një tingëllim tepër të gëzuar, që i pritën nxehtësisht nga publiku, si kënga «Djemtë e lagjes sime», e interpretuar mjaft mirë nga këngëtarja e re Sh. Sadiku (arsimtare nga qyteti i Kavajës), «Kur vjen artisti tek punëtori» etj. Por kemi përshtypjen se, nga pikëpamja e përpjestimeve, shumica e këngëve anonin në tipin e këngës himnizuuese e ndonjëra prej tyre ishte edhe e vështirë për t'u kënduar jo vetëm nga masat, por edhe nga këngëtarët tarë lirikë të mirënjohur. Vumë në dukje këtë

të metë, sepse tanimë, siç dihet jemi përballë një kërkese të kohës për këngë sa më të thjeshta në ndërtim e sa më të qarta e të kuptueshme për masat. Këtu i kemi edhe borboret më të mëdha. Sigurisht, ky është një problem për krejt këngën tonë shqiptare e që nuk zgjidhet vetëm nga një festival. Por na duket se është e nevojshme që, për zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të punojnë të gjithë kompozitorët, të rinj e me përvojë bashkë. Në këtë mënyrë ne do t'u japim masave tona artdashëse gjithnjë këngë të realizuara me art, të thjeshta e që bëhen shpejt pronë e tyre.

Duke dëgjuar me kujdes këngët e këtij festivali, të gëzohem edhe një jetër dukuri pozitive. Cila është ajo? Mendojmë se është kërkesa e madhe e kompozitorëve për të dhënë këngë ku të zotëronte melodinë, për të mbërthyer dëgjuesin qysh në notat e para me emocion

(vijon në f. 15)

«Bashkë me agimin»

– Diskutim krijues –

Javën e kaluar, në Teatrin Popullor, u organizua nga grupi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të teatrit dhe komisioni i dramës i Lidhjes, diskutimi krijues për spektaklin «Bashkë me agimin» - dramë nga Kolë Jakova, e vënë në skenë nga Esat Oktrova, Artist i merituar, me asistentë - regjisorë Drita Pellingu e Dhimitër Pecani.

Veç aktorëve dhe regjisorëve të Teatrit Popullor e shkrimtarëve të ftuar, merrte pjesë edhe sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë Xhemal Dini.

Diskutimin kryesor e mbajti regjisor Piro Mani. Pastaj folën aktorë dhe shkrimtarë: P. Mima, B. Levonja, E. Agolli, T. Laço, N. Prifti dhe L. Filipi. Diskutimi u përqëndrua kryesisht në analizën e spektaklit. Ideja qendrore e dramës, u tha, është një ide aktuale dhe shumë e rëndësishme. Për këtë dhe për mjaft vlera të tjera ideoartistike drejtorja e Teatrit dhe këshilli artistik e mirëpritën dhe e vlerësuan drejt dramën, duke i bërë njëkohësisht autorit edhe disa sugjerime e vërejtje, të cilat ai i mirëpriti dhe punoi me këmbëngulje për t'i realizuar sa më mirë. Atmosfera shoqërore e mirëkuptimi që ishte gjatë vënies në skenë të dramës mi-

dis autorit, regjisë dhe trupës u suall si shembull i mirë i një bashkëpunimi të ngushtë, i cili dha rezultate pozitive.

Shumica e diskutantëve, duke vlerësuar pozitivisht punën e regjisë, thanë se ajo e zbuloi drejt idenë themelore të dramës, i hyri në thelb asaj, prandaj arriti që ta theksojë mirë tendenciozitetin, partishmërinë e spektaklit në mënyrë realiste e të qartë. Ideja se ishte Partia ajo që i ngriti në luftë masat, i bashkoi dhe i udhëhoqi, ndihet mirë në spektakël.

Mizanskena, tha në diskutim P. Mani, është e figurshme, ndihmon mjaft jo vetëm që spektatori të kapë idenë e dramës, por edhe psikologjinë e personazheve. Ajo është e studjuar e lakonike.

Shokët P. Mani, B. Levonja, E. Agolli folën për lojën e mirë të aktorëve si Robert Ndrenjka, në rolin e Shtjefnit, Marije Logoreci e Esma Agolli, në rolin e Drandes, Violeta Manushi e Besa Imami në rolin e Zyrasë, Pavlina Mani në atë të Katrinës etj.

Aktori Ahmet Pasha, tha një diskutant, ka punuar me seriozitet në rolin e Osos, duke kapërcyer në një farë mase edhe ndonjë vështirësi, sepse dramaturgjikisht ky personazh nuk është arritur në shkallën e duhur. Në diskutim u theksua si një kërkese e domosdoshme puna e pa-

ndërprerë që duhet të bëjë aktori me rolin nga shfaqja në shfaqje, për ta ngritur edhe më lart, për të mënjeluar ndonjë mungesë që vihet re në shfaqjet e para. S. Shembull i mirë në këtë drejtim u suall puna e aktorit Prokop Mima, në rolin e Alush Agës.

Nga diskutimi doli gjithashtu se spektakli ka edhe disa dopësi e mungesa. Nga më kryesoret është ajo që në pjesën e dytë tensioni dramaturgjik bie, dhe kjo - nga që konflikti copëzohet e s'përndahet; skalitja e pamjafveshme dramaturgjike e ndonjë personazhi nuk kapërcehet dot nga aktorët dhe i detyron disa here ata të sforcohen. Tek A. Kristofori (prifti) vihet re ndonjë thjeshtëzim, nga A. Pasha u kërkua një komunikim edhe më i ngrohtë, nga R. Arbana (oficeri gjerman) shman-gia e ndonjë reminshence me rolet e mëparshme etj. Gjithashtu, u kërkua që aktorët të depërtojnë edhe më thellë në psikologjinë e personazheve, duke vënë më në pah edhe nuanca të veçorive shoqërore e të krahinës ku zhvillohet ngjarja, si p.sh tek V. Manushi (Drandja), Pavlina Mani (Katrina).

Me të drejtë u fol gjerësisht edhe për rolet e dyta dhe figurantët. Për të patur spektakle të një niveli më të mirë, tha B. Levonja, regjisor i gjithmori duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe ndarjes së roleve, sepse edhe për këtë spektakël ka vend për vërejtje.

Kur foli për artistët e rinj, Lazer Filipi dha mendimin se ata

vërtet duhet të ndihmohen e të mësojnë prej aktorëve më me përvojë, por edhe prej njëri-tjetrit. Gjithashtu ai ngriti edhe problemin e njohjes së jetës prej aktorit, veçanërisht të rinjve. Ne, tha L. Filipi, duhet të njohim mirë sidomos jetën dhe njerëzit e atyre vendeve ku zhvillohet ngjarja.

Në këtë spektakël, ishte mendimi i shumicës, skenografia e Agim Zajmit qe funksionale, e shërben dramën dhe lojës së aktorëve. Skenografia ka një zgjidhje realiste, të lehtë e të manovrueshme nga ana teknike. Jo vetëm skenografisë së këtij spektakli, por problemeve të saj në tërësi, tha E. Agolli, u duhet kushtuar nga kritika artistike e teatrale një vëmendje më e madhe, pasi ajo është pjesë e domosdoshme e përmbytjes së spektaklit dhe ka kërkesat e saj të veçanta.

U ngritën në diskutim edhe probleme të tjera, që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të dramaturgjisë, tek e cila ka një farë papambetjeje relative, plotësisht të kapërcyeshme. U fol edhe për gjuhën letrare, e cila prej aktorëve duhet të përvetësohet më mirë, si edhe për rolin e gjuhës si mjet individualizimi të personazheve.

Pastaj regjisor i spektaklit Esat Oktrova falenderoi diskutantët dhe vlerësoi vërejtjet që u bënë.

Në fund foli kryetarja e grupit të Lidhjes për Teatrin Popullor Violeta Manushi.

Korresp. i «Dritës»